



Pranuar / Dërguar / Priljepti / Prodato / Recevevit / Dërgohej	28 - 03 2023	3	viti / god / year
Organ / Njesia / Organ / Jedinita / Org / Junit	Nr Prot / Nr Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMSHK	3064 / 2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.361/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.361/2023, të datës 15.02.2023 të ankuesit me adrese banimi: Rruga "5 Maji" Fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, kundër Vendimit Nr.125 të datës 07.02.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Rahovecit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.03.2023, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.361/2023 e datës 15.02.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Lista e kandidatëve fitues me numër 110 e datës 02.02.2023 e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa Anullohet procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 12.12.2022 me numër të Referencës: RN00010547 për emrin e grupit "Specialist i Metodave të Arsimit (Metolog Arsimi)", në Komunën e Rahovecit.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Rahovecit, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsy e tim

Ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit "Specialist i Metodave të Arsimit (Metolog Arsimi)" të shpallur nga Komuna e Rahovecit, me datë 15.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar dhe protokolluar me numër 1758/2023, kundër Listës së kandidatëve fitues me numër 110 i datës 02.02.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Komisioni i Pranimit ka zbatuar gabimisht dispozitat e aplikuara ligjore me rastin e vlerësimit të biografisë së kandidatit fitues pasi që i njëjti përvojën e punës nuk e ka në fushën në të cilën zhvillohet procedura dhe se me rastin e përpilimit të testit me shkrim Komisioni ka përfshirë edhe pyetje të cilat nuk kanë të bëjnë me pozitën në të cilën ka aplikuar, me kërkesën që konkursi i kontestuar të anulohet për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të ligjit material..

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 02.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Rahovecit. Ndërsa me datë 13.03.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën e datës 15.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Konkurs i datës 27.01.2021; Ankesa për Komisionin e pranimit i datës 03.02.2023; Vendim me numër 125 i datës 07.02.2023; CV-ja e ankuesit; Kontratë punë për mësimdhënës i datës 01.09.2015; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër 1813 i datës 30.06.2011; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër 189/112 i datës 20.04.2012; Aktvendim mbi licencimin e mësimdhënësit me numër të protokollit 08/2012/8174; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër 6310/670 e datës 08.04.2004; Licencë e mësimdhënësit me numër 100008174 e datës 26.12.2017; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit dhe Edumen Education- Dhjetor 2022; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Instituti i Pedagogjisë i Kosovës; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e vitit 2018; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit- Shkurt 2020; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit e datës 05.07.2020; Certifikatë e lëshuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit, GIZ dhe KCDE-Korrik 2020; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit shkencës dhe teknologjisë e datës 29.09.2006; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, dhe Teknologjisë e datës 01.07.2016; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, dhe Teknologjisë dhe SBASHK e datës 29.11.2015; Certifikatë e lëshuar nga Kosovo Education Development Project; Certifikatë e lëshuar nga Zyra për Qeverisje të mirë, IOM, UNMIK dhe Qeveria e Finlandës; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK- Dhjetor 2019; Certifikatë e lëshuar nga USAID-Prill 2021; Certifikatë e lëshuar

nga Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Maj 2006; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë -Shtator 2018; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Certifikatë e lëshuar nga Qendra për Arsim e Kosovës-Dhjetor 2006; Certifikatë e lëshuar nga Qendra për Arsim e Kosovës e datës 15.03.2017; Certifikatë e lëshuar nga USAID dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-mars 2013; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Instituti i Pedagogjik i Kosovës-2014; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe KEC e datës 08.12.2020; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe KEC me nr.32556/076 e datës 31.05.2021; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe KEC me numër 32302/078 e datës 31.05.2021; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e datës 13.02.2005; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me numër 133; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile i datës 06.06.2019; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë e datës 02.12.2022; Kopje e letërnjoftimit e ankuesit; Pasqyra e llogarisë në Trust për periudhën kohore 12.03.2008 deri 08.12.2022; Certifikatë e lëshuar nga Shtëpia e Sigurt e datës 27.02.2020; Certifikatë e pjesëmarrjes e lëshuar nga QPEA e datës 04.03.2006; Certifikatë e lëshuar nga Qendra Kosovare e të Drejtave të Fëmijëve e datës 25.12.2002; Mirënjohje e lëshuar nga SH.F."Hamëz Thaçi" e datës 05.06.2009; Diplomë e lëshuar nga Federata Kanadeze e Mësuesve e datës 19.12.2011; Certifikatë e lëshuar nga Federata Kanadeze e Mësuesve e datës 09.05.25011; Mirënjohje e lëshuar nga SH.F."Hamëz Thaçi" e datës 06.06.2008; Mirënjohje e lëshuar nga Komuna e Rahovecit e datës 15.11.2012; Mirënjohje e lëshuar nga Komuna e Rahovecit e datës 17.02.2022; certifikatë e lëshuar nga CDRSEE; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.02.2023; Përgjigje në ankesë e datës 13.03.2023; Konkurs i datës 12.12.2022;Vendim me numër 71 i datës 24.01.2023; Konfirmim për përfundimin e konkurrimit me numër 133 i datës 08.025.2023; Lista e kandidatëve fitues me numër 110 i datës 02.02.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 01.02.2023; E-mail i dërguar nga A.Th drejtuar S.K e datës 31.01.2023; E-mail i dërguar nga A.Th drejtuar S.K e datës 24.01.2023;Lista e aplikantëve; Lista e ngushtë me numër 39 e datës 11.01.2023; Akt emërim i A.K i datës 10.12.2018; Ndryshim plotësim i akt emërimit për L.K i datës 07.03.2019; Ndryshim plotësim i akt emërimit për S.H i datës 11.04.2019; Vendim me numër 2625 i datës 23.08.2022; Akt emërim për A.Th i datës 30.10.2012; Kontratë e punës për S.K i datës 16.01.2023; Tabela e Pyetjeve; Pasqyra e llogarisë për A.H për periudhën kohore 15.02.2014 deri 08.02.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; Vërtetim i njësisë nga origjinali datës 05.07.2021;Diplomë e lëshuar nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë me numër të diplomës 351 i datës 28.10.2020; Vërtetim i kopjes nga origjinali me numër LRP.Nr.rendor.12260/2021 i datës 12.10.2021; Vendim me nr.ref.216-4831 i datës 27.10.2021; Diplomë e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina" me numër 105 i datës 08.10.2018; Vula Apostille me numër 58484/18 e datës 10.10.2018; Vërtetim i kopjes nga origjinali me numër LRP.Nr.rendor.5731/2020 i datës 14.10.2020; Marrëveshje për shërbime të veçanta me nr.04-052-3168 i datës 09.09.2019; Marrëveshje për shërbime të veçanta me nr.prot.03/1453 i datës 21.11.2018; Marrëveshje për shërbime të veçanta me nr.prot.01/1002 i datës 25.10.2017; Vërtetim i lëshuar nga Universiteti "Ismail Qemajli" me nr.371/2 i datës 05.07.2021; Vërtetim i lëshuar nga Universiteti "Fehmi Agani" me nr.ref.03/791 e datës 06.05.2022; Letër rekomandimi për A.H e datës 27.06.2022; Kopje e letërnjoftimit për A.H;

Pasqyra e Llogarisë për A.H për periudhën kohore 16.06.2017 deri 21.12.2022; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 16.12.2022; Aplikacion i A.H i datës 03.01.2023; Kontratë pune për mësimdhënës me nr.prot.185 i datës 22.09.2015; Aplikacion i G.K i datës 03.01.2023; Pliko e bardhë me numër R 2794811.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Rahovecit me datë 12.12.2022 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit të pranimit (i jashtëm) për emrin e grupit "*Specialist i Metodave të Arsimit (metolog arsimit)*" me numër të Referencës: RN00010547, ndërsa bazuar në Renditjen Përfundimtare të kandidatëve të datës 01.02.2023 konstatohet fakti se ankuesi ka arritur ti mbledh 28 pikë nga testi me shkrim të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme për të kaluar në fazën tjetër apo për tu zgjedhur si kandidatë fitues.

Ankuesi, i pakënaqur me vlerësimin e rezultateve të testit me shkrim dhe pyetjeve të parashtruara në test, kishte parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa Komisioni i pranimit përmes Vendimit me numër 125 të datës 07.02.2023 kishte refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se pyetjet të cilat ankuesi pretendon se kanë qenë jashtë fushës për të cilën zhvillohet procedura janë pyetje të cilat janë përpiluar nga DMZP/Ministria e Punëve të Brendshme. Në këtë mënyrë pas përfundimit të fazës së ankesave të brendshme me datë 02.02.2023 Menaxheri i Personelit ka nxjerr Listën e kandidatëve fitues lidhur me kandidatin e suksesshëm për pozitën e shpallur të konkursit nga rezulton se ankuesi nuk ishte kandidat i përzgjedhur.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin e shpallur të datës 12.12.2022, për grupin "*Specialist i Metodave të Arsimit (metolog arsimit)*-Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë" me numër të Referencës: RN00010547, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

• **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a të studimeve Universitare-në me të paktën 180, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me edukim.

• **Përvoja e punës:** Se paku dy (2) vite përvoja pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me kërkesën e tij për anulimin e konkursit për shkak se kandidati fitues nuk e ka përmbushur kriterin e konkursit lidhur me përvojën e punës në fushën në të cilën zhvillohet procedura, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullore Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërlidhur me Shtojcën Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, renditja numër 49 e Grupit- *Specialistë të Metodave të Arsimit (metolog arsimit)* ku fusha e kërkuar e arsimit është "**Mësimdhënie apo një degë e caktuar e shkencës përkatëse dhe eksperiencë në mësimdhënie./Psikologji**", andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komuna e Rahovecit me rastin e shpalljes së konkursit të datës 12.12.2022, me numër të Referencës: RN00010547, ka vepruar në kundërshtim me

dispozitat e aplikuara të ligjit material lidhur me përcaktimin e kriterëve të kualifikimeve profesionale, pasi që për grupin e pozitive "*Specialistë të Metodave të Arsimit (metolog arsimit)*" kërkohet që fusha e arsimit të kandidatëve të jetë Mësimdhënie apo një degë e caktuar e shkencës përkatëse dhe eksperiencë në mësimdhënie/Psikologji, ndërsa në konkursin e kontestuar ky kriter nuk ka qenë i përcaktuar.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dokumentet e kandidatëve të cilët kanë aplikuar në këtë konkurs, specifikisht diplomën e studimeve ku ka konstatuar se kandidati fitues A.H ka diplomuar në Fakultetin e Filologjisë/Programi i Gjuhës Shqipe, i cili nuk është ekuivalent me kriteret e kualifikimeve që kërkohen për këtë pozitë, e po ashtu i njëjti nuk ka plotësuar as kriterin e përvojës së punës sa i përket fushës në të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës sipas Rregullore Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sikurse edhe ankuesi ka diplomuar në Fakultetin e Filologjisë/Dega e Historisë, nga rrjedh se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e fushës së kërkuar të arsimit të përcaktuar sipas Shtojcën Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm të Rregullore Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Bazuar si më lartë, nga shkresat e administruara të lëndës si dhe gjetjeve të shkeljeve të rregullave dhe parimeve të pranimit në shërbimin civil lidhur me përcaktimin e kriterëve të konkursit të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i këshillit konstaton se Komuna e Rahovecit me rastin e shpalljes së konkursit të pranimit (i jashtëm) të datës 12.12.2022 për emrin e grupit "*Specialistë të Metodave të Arsimit (metolog arsimit)*" me numër të Referencës: RN00010547, ka vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "*1. Pranimi në detyrë i nëpunësit Civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive*", pasi që me rastin e shpalljes së konkursit kishte përcaktuar kriteret e përgjithshme formale sa i përket arsimimit dhe përvojës së punës në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit njëzëri ka vendosur që proceduar e kontestuar përmes kësaj ankese të anulohet në tersi, gjegjësisht Lista e kandidatëve fitues me numër 110 i datës 02.02.2023 është shfuqizuar, ndërsa Konkursi i shpallur me datë 12.12.2022, për grupin "*Specialistë të Metodave të Arsimit (metolog arsimit)*" me numër të Referencës: RN00010547 është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi Komuna e Rahovecit nuk ka përfillur kriteret e pacaktuara me Rregulloren Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, nga rrjedh se kërkesa e ankuesit për anulimin e konkursit është e bazuar në ligj.

Sa i përket pretendimit lidhur me përbërjen e Komisionit të Pranimit, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin për themelimin e Komisionit dhe akt emërimet e anëtarëve të komisionit dhe ka konstatuar se përbërja e Komisionit të Pranimit është në përputhje me nenin 17 paragrafi 2 të Rregullore (QRK) nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: "*2.Komisionet e Pranimit në pajtim me paragrafin 1 të këtij*

neni përbëhen nga: 2.1. një (1) anëtar nga Njësia Përgjegjëse, i cili kryeson komisionin; 2.2. tre (3) anëtarë nga nëpunësit civilë të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, që ushtrojnë detyrën në pozita pune të specializuara lidhur me fushë e njohuri, aftësi dhe cilësi për të cilat kryhet vlerësimi i kandidatëve dhe që ushtrojnë detyrën në një institucion të administratës shtetërore; 2.3. një (1) ekspert i jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore, nga organizata të specializuara apo universitetet e fushës.”

Nga se u tha më lartë, Kolegji i Këshillit meqenëse ka konstatuar se me rastin e hapjes së konkursit të kontestuar me këtë ankesë nuk janë përfillur parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, ka vendosur njëzëri se përbën bazë të mjaftueshme ligjore që konkursi të anulohet në tersi, ndërsa nuk është lëshuar në shqyrtim e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit për asnjë fazë tjetër të rekrutimit apo veprim procedural që ndërlidhen me çështjen e pyetjeve të testit, pasi që nuk do të kishte asnjë efekt të ndryshëm juridik.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.361/2023, datë 28/03/2023

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.